

VENDIM
Nr. 46, datë 3.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.10.2023. mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (G) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Gëzim Boçari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronave,
Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Konstatimi se vendimi nr. 18, datë 17.11.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afateve ligjore, përcaktuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile.

Anulimi i vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Përsheptimi i gjyimit dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga zvarritja e gjyimit tej afateve ligjore, e kërkuar me kërkesën e datës 3.10.2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 3, 41, pika 2, 122, pika 2, 131, pika 1, shkronja “F”, 181, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 2, 27, 28, 29, 30, 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*) dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gëzim Boçari¹ së bashku me shtetasit A.Gj., K.Gj., S.Gj., A.Gj. e E.Gj., në cilësinë e trashëgimtarëve të shtetasve E.D. dhe M.D. (Gj.), i janë drejtuar me kërkesë Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRAKKP*) Vlorë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi një sipërfaqe 950 vreten, të ndodhur në rrethin e Vlorës. Me vendimin nr. 58, datë 31.8.2007, *ZRAKKP*-ja, Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, për shkak të mangësisë dhe të metave në dokumentacionin ligjor, si dhe për shkak të mbivendosjes që krijon planvendosja me disponimet e bëra me vendimet nr. 38, datë 18.5.1994, nr. 38/1, datë 18.5.1994

¹ Sipas vendimeve gjyqësore mbimëri i kërkuarit rezulton Gjonboçari.

dhe nr. 81, datë 14.6.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë dhe vendimin nr. 52, datë 13.8.2007, të ZRAKKP-së, Vlorë, i ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 15.1.2008, të drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), për njohjen dhe kthimin fizikisht të disa pasurive të paluajtshme, sipërfaqe toke, trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit I. A., si dhe vendimin nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, me të cilin është njohur pronar dhe i është njohur e drejta e kompensimit shtetases K.B. Vendimi i ZRAKKP-së Vlorë është kundërshtuar në AKKP, e cila ka vendosur lënien e tij në fuqi me vendimin nr. 415, datë 22.4.2008, me të njëjtin arsyetim.

2. Po mbi kërkesën e të njëjtave subjekte, ZRAKKP-ja, Vlorë, me vendimin nr. 59, datë 31.8.2007, ka vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënës M.D.(Gj.) për një sipërfaqe toke 150 vreten, të ndodhur në rrethin e Vlorës, me arsyetimin se pretendimet e kërkesësve nuk janë provuar dhe se kjo pasuri krijon mbivendosje me disponimet e bëra me vendimin nr. 38/1, datë 19.5.1994, të KKKP-së, Vlorë dhe nr. 52, datë 13.8.2007, të ZRAKKP-së, Vlorë. Edhe ky vendim është kundërshtuar në AKKP, e cila, me vendimin nr. 414, datë 22.4.2008, ka vendosur lënien e tij në fuqi. Trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarëve E.D. dhe M.D.(Gj.) i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt anulimin e tyre, si dhe detyrimin e të paditurve F.M., P.G., M.G., S.L., Z.V., M.Xh., K.B. dhe A.L. t'i njohin pronarë për ato sipërfaqe që janë trajtuar me vendimet objekt padie dhe që janë brenda pronës së pretenduar nga paditësit, si dhe detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë të regjistrojë këto prona dhe t'i regjistrojë në favor të paditësve.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1814, datë 6.7.2009, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Mbi bazën e ankimit të veçantë të paditësve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 26.11.2009, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, të cilat, me vendimin nr. 2, datë 21.1.2011, kanë vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1056, datë 23.6.2014, ka vendosur të pranojë pjesërisht padinë, duke pranuar kërkimet për: konstatimin si akt absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së Vlorë, të dhënë në favor të K.B., për rrjedhojë edhe të kontratës së dhurimit të datës 10.9.1999, të lidhur ndërmjet saj dhe E.L.; njohjen dhe kthimin fizik të pasurisë 4131,8 m² në parcelën nr. 31, Jonufër, Vlorë bashkëtrashëgimtarëve të ish-pronarëve E.D. dhe M.D.(Gj.); detyrimin e palëve të paditura K.B. dhe E.L. të njohin si pronarë paditësit për këtë pasuri (pikat 7–9 të dispozitivit). Në lidhje me kërkimet e tjera gjykata ka vendosur rrëzimin e tyre dhe konkretisht ato për: anulimin pjesërisht të vendimeve nr. 38, datë 18.5.1994, nr. 38/1, datë 18.5.1994 dhe nr. 81, datë 14.6.1995, të KKKP-së, Vlorë, nr. 52, datë 13.8.2007, të ZRAKKP-së, Vlorë dhe nr. 18, datë 15.1.2008, të AKKP-së (pikat 1–5 të dispozitivit); detyrimin e palëve të paditura, trashëgimtarë të ish-pronarit I.A., të njohin si pronarë paditësit për pronat e individualizuara në mbivendosje (pika 6 e dispozitivit); anulimin e vendimeve të kthimit dhe kompensimit të pronave, me të cilat është refuzuar kthimi i pronës që nuk krijon mbivendosje me të paditurit dhe për pjesën që krijon mbivendosje me palët e paditura trashëgimtarë të I. A. (pika 10 e dispozitivit); detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të regjistrojë pasuritë e paluajtshme në favor të paditësve (pika 11 e dispozitivit). Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim paditësit, si dhe të paditurit K.B. dhe A.L.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 329, datë 15.3.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1056, datë 23.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me pikat 2, 3, 4, 5, 6, 10 dhe 11 të tij dhe ndryshimin e vendimit në pikat 1, 7, 8, 9 dhe 12, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkesi Gëzim Boçari në datën 19.11.2017, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë me numër nr. 11111-01272-00-2018, datë 16.4.2018.

6. Për shkak se për çështjen e tij nuk kishte ende një datë të planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, në datën 3.10.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, në situatën që kishte kaluar një periudhë prej më shumë se 4 vjetësh nga regjistrimi i saj, duke pretenduar se është shkelur afati i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur edhe me mendimin me shkrim të gjyqtarit relator, me vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas tij, çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në atë gjykatë, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, dhe kërkuesi nuk ka pasur sjellje që të kenë shkaktuar vonesa të paarsyeshme në gjykim, por, nga ana tjetër, nuk vlerësohet se vjen ndonjë rrezik i veçantë për të nga mosgjykimi në afat i kësaj çështjeje. Vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret, që lidhet me efektet e reformës në drejtësi (*shih paragrafët 17 dhe 18, të vendimit të Kolegjit Penal*). Në kushtet kur Gjykata e Lartë është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e kësaj çështjeje, pasi janë shumë çështje të tjera më të vjetra se ajo, me të njëjtën shkallë apo edhe shkallë më të lartë përparësie, të cilat presin për gjykim, nuk mund të gjejë zbatim mekanizmi zhbllokues, për shkak të parashikimit të nenit 399/2, pika 3, të KPC-së (*shih paragrafin 33, të vendimit të Kolegjit Penal*).

8. Me kërkesën e datës 30.1.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes së tij civile të regjistruar në atë gjykatë, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosshqyrtimi i saj brenda afatit ligjor.

9. Me vendimin e datës 5.4.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Me vendimin e datës 13.4.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarit të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, kurse me vendimin e datës 18.4.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor për sa vijon:

10.1 Proces i gjyqësor në tërësi ka zgjatur mbi 14 vjet, nga të cilat mbi 5 vjet në Gjykatën e Lartë. Edhe pse Kolegji Penal ka konstatuar shkeljen e afatit 2-vjeçar të gjykimit, nuk është shprehur për përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit siç përcakton neni 399 i KPC-së. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, ka konstatuar shkeljen e neneve 6, pika 1 dhe 13 të Konventës, duke ndëshkuar shtetin shqiptar, ndërkohë që ekzekutimi i tij mbahet peng nga shqyrtimi i çështjes së kërkuetit.

10.2 Konflikti duhej të ishte zgjidhur nga ATP-ja pa pasur nevojë për proces gjyqësor, duke plotësuar mangësinë materiale, që është firma pro ose kundër e kryetarit të komisionit në vendimin e KKKP-së nr. 109 të vitit 1996. Mosekzekutimin e vendimit nr. 502, datë 6.3.2003, të Gjykatës së Lartë, për të cilin GJEDNJ-ja ka dënuar shtetin shqiptar, e vërteton edhe dokumenti i Zyrës Përmbartimore nr. 676 prot., datë 5.10.2020.

10.3 Kërkesa për përshpejtim nuk u mor në konsideratë edhe pse bashkëlidhur saj u paraqit dokumenti i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që provon se gjatë kohës që po zhvilloheshin proceset gjyqësore prona i është nënshtruar një afere korruptive, duke bërë pronarë persona të tretë, të cilët nuk kanë asnjë të drejtë trashëgimie. Privatizimet e pronës janë bërë mbi shkresa

abuzive dhe pa bazë ligjore, çka është shkelje e nenit 92 të Kodit Civil. Ndaj vendimi i Kolegjit Penal mbron transferimin e paligjshëm të trojeve që u përkasin familjes Boçari.

10.4 Në vijim të vendimeve abuzive në pronën e konfiskuar familjes Boçari në vitin 1947, është edhe vendimi nr. 00-2022-1098 (242), datë 10.6.2022, i Kolegjit Civil, çështje për të cilën edhe pse u kërkuar të bashkohet me çështjen që ndodhet në pritje të gjyqimit, kjo nuk u mor në konsideratë. Moshqyrtimi së bashku i këtyre çështjeve ka mundësuar deformimin tërësisht të provave dhe ka maskuar mungesën e bazës ligjore të kërkesës së paraqitur nga P.G. për rishikimin e vendimit nr. 199, datë 6.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

10.5 Rreziku nga shtyrja e afateve kohore do të sjellë pasoja të parikuperueshme, pasi kompensimi nga zbatimi i projektit “Lungomare 3”, që do të fillojë në vitin 2023, do të përfitohet nga familja e shtetasit I.A. dhe persona të tjerë që nuk kanë asnjë dokument autentik të kohës për të provuar se janë pronarët e shpronësuar. Vendimi i Gjykatës së Lartë maskon faktin se subjekti i shpronësuar, familja Boçari, ka paraqitur kërkesëpadinë e datës 7.1.1993, për njohjen pronar dhe kthim sendi, si dhe faktin se objektet e privatizuara janë ndërtime provizore, baraka të rrënuara të ngritura në trojet e pronarit dhe mbi themelet e ndërtimeve ekzistuese të tij. Për procesin që kërkohet të përshpejtohet dokumentet e pronësisë për familjen Boçari nuk kundërshtohen, pasi janë nxjerrë nga Arkiva e Shtetit.

11. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1 Pretendimet e kërkuarit janë haptazi të pabazuara, pasi vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është ezauruese dhe e mbështetur në parashikimet e nenit 399/5 të KPC-së, duke respektuar kufijtë e objektit të kërkesës dhe dispozitave ligjore. Kërkimet dhe argumentet e kërkuarit krijojnë kontradiktoritet me objektin e kërimit pranë Gjykatës së Lartë, pasi ai ka pretenduar se ajo duhej të ishte shprehur për pretendimet e paraqitura në rekurs, ndërkohë që konstatimi i shkeljes së afatit ligjor nuk ka lidhje me pretendimet për themelin e çështjes.

11.2 Në lidhje me kriterin e periudhës që duhet marrë në konsideratë, Gjykata e Lartë ka konstatuar se është kaluar afati i shqyrtimit në atë gjykatë, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, por kjo vonesë është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Për sa i përket kompleksitetit të çështjes, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, pasi thelbi i saj lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës private, ndaj përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 42 dhe shqyrtimi i saj paraqet elemente kompleksiteti.

11.3 Kriteri i interesit dhe sjelljes së kërkuarit ka të bëjë me mënyrën se si janë sjellë palët në proces dhe faktorë të tjerë lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre, që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Lidhur me sjelljen e autoriteteve, sipas vendimit të Kolegjit Penal, gjyqtari relator ka marrë në shqyrtim kërkesën për përshpejtim dhe është shprehur se është duke marrë masat maksimale për përballimin e çështjeve të prapambetura dhe shqyrtimin e tyre sa më parë të jetë e mundur. Ligjvënisi ka parashikuar shprehimisht rrethanat e pamundësisë objektive si shkak objektiv që shkarkon nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit.

11.4 Pretendimi për shpërblimin e dëmit nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal është pjesa finale e procedurës për-shpërblimin e drejtë. Në kushtet kur Gjykata e Lartë është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e çështjes, nuk mund të gjejë zbatim mekanizmi zhblllokues.

11.5 Për sa i përket pretendimit për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, ai është i pabazuar dhe nuk përbën objekt shqyrtimi në rastin konkret. Për ekzekutimin e atij vendimi, që i detyronte autoritetet të ekzekutonin vendimin nr. 502, datë 6.3.2003, të Gjykatës së Lartë, AKKP-ja ka marrë vendimin nr. 45, datë 11.3.2009, që bazohej në dosjen e pronës nr. 578/2, për të cilën ishte marrë vendimi nr. 109 i vitit 1996, i KKKP-së, me të cilin u ka njohur të drejtën e pronësisë paditësve për sipërfaqen 819,917 m², në vendin e quajtur “Shkalla”, Jonufër, Vlorë, u ka kthyer sipërfaqen 484,551 m² dhe i ka kompensuar për sipërfaqen 321,766 m². Janë vetë paditësit që kanë kundërshtuar në gjykatë vendimet e KKKP-së dhe AKKP-së.

12. Subjektet e interesuara, ATP-ja dhe ASHK-ja, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

15. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata vëren se pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ajo ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se kërkuari i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në atë gjykatë, për të cilën Kolegji Penal, me vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuarit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

17. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave mban datën 17.11.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.1.2023, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarit të regjistruar në Gjykatën e Lartë, për të cilën ende nuk ka një vendimmarrje dhe as një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Edhe pse kërkuari ka ngritur disa pretendime që lidhen me të drejtën e pronës dhe paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga persona të tretë, apo të drejtat potenciale që mund t’u burojnë atyre nga pasuritë objekt të mosmarrëveshjes civile, ai i ka lidhur ato me vonesat në shqyrtimin e çështjes së tij. Për rrjedhojë, Gjykata do t’i vlerësojë pretendimet e kërkuarit vetëm në këndvështrim të

kohëzgjatjes së procesit gjyqësor të kundërshtuar, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

19. Për sa i përket kërimit për shpërblimin e dëmit për shkak të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata thekson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, shqyrtimi i këtyre kërkesave nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, prandaj kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 17, datë 29.6.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

20. Sipas kërkuetit, procesi gjyqësor në tërësi ka zgjatur mbi 14 vjet, nga të cilat mbi 5 vjet në Gjykatën e Lartë. Edhe pse Kolegji Penal ka konstatuar shkeljen e afatit 2-vjeçar të gjykimit, nuk është shprehur për përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit siç përcakton neni 399 i KPC-së. Shqyrtimi i çështjes së tij mban peng edhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, ndërkohë që vendimi i Kolegjit Penal mbron transferimin e paligjshëm të trojeve që u përkasin familjes Boçari. Po kështu, rreziku nga shtyrja e afateve kohore do të sjellë pasoja të parikuperueshme, pasi kompensimi nga zbatimi i projektit “Lungomare 3”, që do të fillojë në vitin 2023, do të përfitohet nga familja e shtetasit I. A. dhe persona të tjerë që nuk kanë asnjë dokument autentik të kohës për të provuar se janë pronarët e shpronësuar.

21. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përfshihen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata, lidhur me kohëzgjatjen tërësore të çështjes, duke iu referuar rrethanave të saj (*shih paragrafët 1-7 të vendimit*), konstaton se ajo është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë fillimisht më 30.5.2009 dhe pas kthimit nga Kolegjet e Bashkuara është regjistruar në po atë gjykatë më 1.8.2011 dhe deri në dhënien e vendimit të gjykatës së apelit (15.3.2017), gjykimi i saj ka zgjatur rreth 8 vjet. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, në Gjykatën e Lartë është regjistruar çështja nr. 11111-01272-00-2018, datë 16.4.2018. Për qëllime të këtij gjykimi Gjykata ka kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i kësaj çështjeje. Me shkresën nr. 4564/1 prot., datë 20.9.2023, Gjykata e Lartë ka kthyer përgjigje se aktualisht çështja është në fazën e studimit dhe se ende nuk ka një planifikim për marrjen e saj në shqyrtim nga trupa gjyqësore e Kolegjit Civil. Për rrjedhojë, çështja e kërkuetit në Gjykatën e Lartë është në pritje të shqyrtimit prej më shumë se 5 vjetësh.

23. Gjykata vëren se me ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, në parashikimet ligjore për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ligjvënësi ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë, që zgjatet edhe me 1 vit e 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109, i ligjit nr. 38/2017). Për rrjedhojë, duke konsideruar se çështja e kërkuetit ndodhet në pritje të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë prej më shumë se 5 vjetësh, duke tejkaluar kështu afatin e parashikuar për këtë lloj gjykimi nga KPC-ja, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuetit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata zbaton këto kritere: *i.* sjelljen e kërkuetit; *ii.* kompleksitetin e çështjes; *iii.* sjelljen e autoriteteve; *iv.* rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 34, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Sjellja e kërkuetit

24. Sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuetit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka

vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Pasi ka pritur planifikimin e datës për shqyrtimin e rekursit të tij, kërkuesi i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 3.10.2022, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së, dhe pasi është njohur me vendimin e Kolegjit Penal të asaj gjykate, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ka paraqitur ankim kushtetues individual me të njëjtin objekt. Për rrjedhojë, kërkuesi dhe paditësit e tjerë në procesin gjyqësor kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

ii. Kompleksiteti i çështjes

26. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile dhe thelbi i saj lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ndaj ky gjykim përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 42 dhe shqyrtimi nga Gjykata e Lartë paraqet elemente kompleksiteti.

27. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi, edhe pse në dukje paraqitet komplekse, ajo nuk do të shqyrtohet në rastin konkret në këtë drejtim, për sa kohë që vetë Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar kërkesën e kërkuesit në drejtim të elementeve që përcaktojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, por ka vendosur rrëzimin e saj mbi konsiderata që lidhen me rrethanat objektive, referuar situatës së përgjithshme në sistemin gjyqësor.

29. Gjykata, megjithatë, vlerëson të theksojë se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Me fjalë të tjera, edhe pse kjo çështje, referuar objektit të saj, numrit të palëve ndërgjyqëse dhe volumit të akteve shkresore e dokumenteve të administruara në gjykim, mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, kjo mund të mos jetë e tillë në Gjykatën e Lartë, për shkak të natyrës së atij gjykimi dhe procedurës së gjykimit në dhomën e këshillimit, si dhe funksionit të saj si gjykatë e ligjit, pavarësisht kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe ndryshimeve të vazhdueshme e të shpeshta përgjatë viteve si të akteve ligjore, ashtu edhe të atyre nënligjore. Pra, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit.

iii. Sjellja e autoriteteve

30. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, referuar vendimit të Kolegjit Penal, gjyqtari relator, pasi është njohur me kërkesën për përshpejtim dhe e ka marrë në shqyrtim, është shprehur se është duke marrë masat maksimale për përballimin e çështjeve të prapambetura dhe shqyrtimin e tyre sa më parë të jetë e mundur. Edhe referuar nenit 399/2, pika 3, të KPC-së në kohëzgjatjen e gjykimit nuk llogaritet koha kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

31. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të*

Gjykatës Kushtetuese). Edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se nismat procedurale u takojnë palëve, kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 38, datë 25.4.2017; nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata, duke pasur parasysh efektet që solli reforma në sistemin e drejtësisë, ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës dhe zgjidhjen e saj. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimet nr. 25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe pse sistemi gjyqësor në tërësi po përballet me ngarkesë, si rezultat i zbatimit të kësaj reforme, kjo problematikë e përgjithshme nuk mund të rëndojë ose të justifikojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkuesve (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 25, datë 11.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në këtë kuptim, vetëm ato vonesa që i atribuohen shtetit mund të justifikojnë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, pasi ai është përgjegjës për të gjitha autoritetet shtetërore, jo vetëm organet gjyqësore. Sipas GJEDNJ-së, ndërkohë që neni 6 kërkon që procedurat gjyqësore të jenë të shpejta, ai, gjithashtu, vë theksin në parimin më të përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë (*shih Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë (vendim) [DhM], maj 2021, § 132*). Megjithatë, një mbingarkesë kronike nuk mund të justifikojë zgjatjen e tepërt të procedurave (*shih Probstmeier kundër Gjermanisë, 1997, § 64*). Metodatat që mund të konsiderohen si një mjet i përkohshëm përfshijnë zgjedhjen për t'i trajtuar çështjet në një rend të caktuar, bazuar jo vetëm në datën e paraqitjes, por në shkallën e tyre të urgjencës dhe të rëndësisë dhe, në veçanti, në rëndësinë e asaj që rrezikojnë personat e interesuar. Megjithatë, nëse një situatë e tillë zgjatet dhe bëhet çështje organizimi strukturor, metoda të tilla nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efektive (*shih Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës, 1983, § 29; Guincho kundër Portugalisë, 1984, § 40*). Fakti që situata të tilla të prapambetura janë bërë të zakonshme nuk justifikon zgjatjen e tepërt të procedurave (*shih Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, 1989, § 40*).

34. Gjykata rithekson, siç evidentoi në lidhje me kriterin e kompleksitetit të çështjes (*shih paragrafin 28 të vendimit*), se në vendimin e Kolegjit Penal mungon analiza dhe arsyetimi në lidhje me plotësimin e kriterëve që justifikojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, duke e bazuar qëndrimin e tij në faktin se vonesa në shqyrtimin e çështjes së kërkuesit në atë gjykatë është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret, që lidhet me efektet e reformës në drejtësi dhe se ajo është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përsheptimin e kësaj çështjeje, pasi janë shumë çështje të tjera më të vjetra, me të njëjtën shkallë apo edhe shkallë më të lartë përparësie, të cilat presin për gjykim (*shih paragrafët 17, 18 dhe 33, të vendimit të Kolegjit Penal*).

35. Gjykata vlerëson të theksojë se zanafilla e këtij procesi është sjellja e autoriteteve, e cila është bërë shkas për lindjen e konfliktit gjyqësor të iniciuar nga kërkuesi për mbrojtjen e së drejtës së pronës private të pretenduar të cenuar për shkak edhe të veprimeve të organeve administrative. Kjo çështje ka mbi 5 vjet që është në pritje të gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe ende nuk ka një perspektivë të qartë se kur do të gjykohet. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh këtë fakt, si dhe faktin që pretendimet kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë së kërkuesit, Gjykata arrin në përfundimin se sjellja e autoriteteve shtetërore nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit.

iv. Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi

36. Kriteri i interesit të kërkuetit dhe rëndësisë së asaj që ai rrezikon nga tejzgjatja e procedurave përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Gjykata vëren se pretendimet e tij, në thelb, kanë të bëjnë me njohjen e pronësisë për disa pasuri të paluajtshme, për të cilat paditësit, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarëve, kanë kërkuar njohjen dhe kthimin ose kompensimin e tyre nga organet administrative.

37. Në lidhje me procesin në pritje të gjykimit në Gjykatën e Lartë, ai ka të bëjë me kundërshtimin e vendimeve të organeve administrative që janë shprehur për të drejtën e pronës së paditësve, si dhe të vendimeve të organeve administrative që kanë disponuar në favor të disa personave të tjerë (pala e paditur në procesin gjyqësor) për disa pasuri që ata pretendojnë se mbivendosen me pasuritë e tyre, pasi që është rrëzuar me vendim të gjykatës së apelit. Objekt i këtij gjykimi është edhe konstatimi absolutisht i pavlefshëm i vendimit nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, të dhënë në favor të shtetases K. B., për rrjedhojë edhe i kontratës së dhurimit të datës 10.9.1999, të lidhur ndërmjet saj dhe shtetasit E. L.

38. Rezulton, gjithashtu, se kërkueti kanë iniciuar disa procese gjyqësore që lidhen me pasuritë të paluajtshme të ndodhura në rrethin e Vlorës dhe po kështu, rezulton se vendimi i KKKP-së nr. 63, datë 19.10.1997, ka qenë objekt edhe i një procesi tjetër gjyqësor të vënë në lëvizje nga paditësit, që më tej është kundërshtuar prej tyre në GJEDNJ. Më konkretisht, kërkueti Gëzim Boçari ka kërkuar në gjykatë dhënien e formës ligjore vendimit nr. 109, datë 27.8.1996, të KKKP-së, Vlorë, me të cilin trashëgimlënësve të paditësve u është njohur dhe kthyer një sipërfaqe toke truall 6100 m², e ndodhur në Jonufër, Vlorë, akt ky që i mungonte forma, pasi kishte mungesë të nënshkrimeve të anëtarëve të komisionit. Po kështu, ai ka kërkuar edhe anulimin e vendimit të KKKP-së nr. 63, datë 19.10.1997, me pretendimin se ka mbivendosje me pronën e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 195, datë 6.2.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 295, datë 25.5.2001. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 502, datë 6.3.2003, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe detyrimin e KKKP-së, Vlorë, të nxjerrë vendimin në formën e kërkuar nga ligji dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin për vendimin nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, duke vlerësuar se ky kërkim është i lidhur me kërkimin e parë të padisë.

39. Kërkueti i është drejtuar GJEDNJ-së për shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (*aplikimi nr. 10508/02*). GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 23.10.2007, ka gjetur shkelje të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për rreth 4 vjet nga data e marrjes së tij (*shih Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë*, §§ 53, 54). Pasi ka marrë në shqyrtim edhe kohëzgjatjen e të tria proceseve gjyqësore në të cilat ankuesit ishin palë, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se kohëzgjatja e procesit që ka të bëjë me procedurat për kthimin e pronës shtetases K.B. nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës (*po aty*, §§ 67, 68).

40. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se pas vendimit të sipërcituar të GJEDNJ-së, mbi bazën e kërkesës së një prej trashëgimtarëve të familjes Boçari për kthimin e një sipërfaqeje kullotë, tokë bujqësore dhe truall me sipërfaqe 819,917 m², të ndodhur në Jonufër, Vlorë, ZRAKKP-ja, Vlorë, me vendimin nr. 45, datë 11.3.2009, ka vendosur të njohë të drejtën e pronësisë mbi këtë sipërfaqe, të kthejë sipërfaqen e përgjithshme 494,551 m² trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar A.D. dhe M.D. (Gj.), të mos kthejë sipërfaqen 325,366 m², pasi është e zënë, si dhe të njohë të drejtën e kompensimit për sipërfaqen 321,766 m². Sipas këtij vendimi prona e pretenduar ka mbivendosje me pasuritë e njohura dhe të kthyer trashëgimtarëve të shtetasit I.A. dhe se brenda kësaj pasurie është disponuar në emër të shtetases K. B. me vendim të KKKP-së të vitit 1997.

40. Duke pasur parasysh sa më sipër, çështja në pritje të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë ka për objekt të saj të drejtën e pronësisë së kërkuetëve, e cila pretendohet se është cenuar edhe për shkak të akteve administrative të kundërshtuara gjyqësisht që u kanë njohur palëve të paditura të

drejtën e kthimit ose kompensimit fizik mbi pasuri për të cilat paditësit pretendojnë se ka mbivendosje me pronën që u buron nga trashëgimia, mes të cilave edhe vendimi nr. 63, datë 19.10.1997, i KKKP-së Vlorë. Gjykata ka theksuar se zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, siç evidentohet edhe në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë dhe siç rezulton edhe nga aktet e dosjes gjyqësore, ka disa procese gjyqësore të iniciuara nga paditësit, ndërkohë që ata nuk kanë ende një vendim përfundimtar të gjykatës në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë të pretenduar të cenuar. Për rrjedhojë, duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë paditësit si palë në procesin gjyqësor.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe përshpejtimit të procedurave, është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet pjesërisht. Për më tepër, Gjykata vëren se për pjesën takuese të pronës së paditësve, për të cilën është disponuar me vendimin nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, vonesat në këtë gjykim kanë bërë të pazbatueshëm, pjesërisht, edhe vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë.

43. Bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon të caktojë afatin 6-mujor brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata e Lartë, pasi në vlerësimin e saj ky afat konsiderohet i arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkuesit, por, gjithashtu, u përgjigjet kushteve dhe mundësive aktuale të asaj gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen gjyqësore nr. 11111-01272-00-2018 akti brenda 6 muajve.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.10.2023.

Shpallur më 1.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë : Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtare kundër: Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 1 (G) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkesit Gëzim Boçari, me objekt: *“Konstatimi se vendimi nr. 18, datë 17.11.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afateve ligjore, përcaktuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile. Anulimi i vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Përsheptimi i gjykimit dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, e kërkuar me kërkesën e datës 3.10.2022”*, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësoj se duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

2. Në analizë të kriterëve vlerësues të kohëzgjatjes së afateve të gjykimit, për kriterin *“Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi”*, shumica ka vlerësuar se: *“...duke mbajtur në vëmendje gjetjet e GJEDNJ-së në vendimin e datës 23.10.2007 për çështjen e kërkesit për tejzgjatjen e procedurave të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, si dhe rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret ka rëndësi në drejtëm të asaj që rrezikojnë paditësit si palë në procesin gjyqësor”*. (shih paragrafin 41 të vendimit). Në përfundim, shumica ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen gjyqësore nr. 11111-01272-00-2018 akti, brenda 6 muajve, duke vlerësuar se pretendimi i kërkesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtëm të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe përsheptimit të procedurave, është i bazuar, ndaj kërkesa duhet të pranohet pjesërisht.

3. Në drejtëm të rrezikut që passjell për kërkesin tejzgjatja e procedurave, vlerësoj se, në thelb, kjo çështje nuk rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit, pasi ajo çfarë kërkuesi rrezikon në këtë konflikt gjyqësor nuk përfshihet në të drejta dhe interesa të natyrës veçanërisht serioze. Duke konsideruar dhe analizuar më në thellësi se çfarë pasoje ose rreziku sjell për kërkesin tejzgjatja e procesit, çmoj se shumica duhej të kishte dalë në konkluzion të ndryshëm për çështjen.

4. Në vlerësimin tim, referuar analizës së vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual, rezulton se kjo e fundit nuk ka cenuar kriteret kushtetuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit gjyqësor, duke marrë në konsideratë secilën prej tyre dhe në tërësi çështjen.

5. Konkretisht, në përgjigje të shkresës së datës 17.10.2022, të kancelarit të gjykatës, gjyqtari relator, të cilit i ka kaluar për shqyrtim çështja e themelit të kërkesit, ka paraqitur mendimin e tij me shkrim, duke argumentuar se në Kolegjin Civil të kësaj gjykate ndodheshin për shqyrtim 18.000 çështje civile dhe se po shqyrtoheshin çështje më të hershme në kohë, sipas datës së regjistrimit, kriter ky i përcaktuar në nenin 460 të KPC-së, ku më e hershmja i përkiste vitit 2011. Po sipas relatorit, kolegji kishte në shqyrtim në seancë gjyqësore çështje që u përkisnin viteve 2011, 2012, 2013 dhe në dhomë këshillimi çështje të regjistruara në vitin 2014. Çështja e kërkesit ishte regjistruar në vitin 2018 dhe asaj nuk mund t'i jepej përparësi, pasi nuk paraqiste shkaqe të veçanta që prevalonin mbi kriterin e radhës së regjistrimit, referuar vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së. Po kështu, në vlerësim të kërkesës së kërkesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimit të procedurave, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar se çështja e kishte kaluar afatin e shqyrtimit të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së (2 vjet në kushtet e ometimit në Gjykatën e Lartë), pasi nga data e regjistrimit të saj kishin kaluar më shumë se 4 vjet, ndërkohë që ka çmuar se kërkesit nuk i vinte ndonjë rrezik i veçantë nga mosgjykimi në afat i çështjes (shih vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqet 3 dhe 5, paragrafët 9 dhe 17).

6. Po sipas Gjykatës së Lartë, askujt nuk mund t'i kërkohej të bëjë të pamundurën dhe për më tepër të bëhet përgjegjës për pamundësinë objektive absolute për evadimin e çështjeve, në

kushtet e një numri të kufizuar burimesh njerëzore dhe një numri tepër të lartë të stokut të çështjeve. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe urdhërimi i marrjes së masave konkrete për përshpejtimin e gjykimit është një institut që synon të korrektojë rastet e pakujdesive ose veprimeve të parregullta të gjykatave në planifikimin e gjykimit në kohë të çështjeve. Ky institut synon të rregullojë anomali individuale dhe zbatohet në ato rastet kur gjykimi jashtë afateve të arsyeshme është përjashtim dhe jo rregull praktik (për shkak të ngarkesës së madhe dhe mungesës së theksuar të burimeve njerëzore). Në kushtet kur situata objektive është e tillë që nuk mund të rregullohen anomalitë, pasi objektivisht nuk mund të procedohet me gjykimin e çështjeve, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë, nuk ka vend që të urdhërohet shqyrtimi me përshpejtim i kësaj çështjeje, duke lënë pa gjykuar çështje të tjera të ngjashme apo më urgjente e më të vjetra, të cilat edhe ato duhet të gjykohen sipas radhës së paraqitjes në gjykatë (*shih vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 6, paragrafi 21*).

7. Në linjë të këtij arsyetimi, si gjyqtare në pakicë, çmoj të rëndësishme të sjell në vëmendje edhe qëndrimin e Gjykatës në lidhje me garancinë e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së për sa i përket detyrimit për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda një afati të arsyeshëm.

8. Kështu, në drejtim të kriterit “Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi”, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete (*shih vendimin nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në këndvështrim të vlerësimit të kriterit “Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi” sipas jurisprudencës kushtetuese, sikundër theksova dhe më lart, çmoj se në rastin e kërkuesit nuk është interpretuar drejt nga shumica, pasi një kriter i tillë nuk lidhet me llojin e së drejtës së kontestuar, por me cilësitë e veçanta të kërkuesit ose natyrën e çështjes së themelit, për shqyrtim në gjykatën në vonesë, e cila për shkak të tejzgjatjes edhe mund të humbasë si e drejtë dhe të mos arrihet të rivihet në vend për shkak të tejzgjatjes së paarsyeshme. Një interpretim i këtij kriteri sipas qëndrimit të mbajtur nga shumica, pra duke e lidhur atë me thelbin e së drejtës së pretenduar si të cenuar, për të cilën është vënë në lëvizje procesi gjyqësor (rasti konkret e drejta e pronës), do të thotë se katalogu i të drejtave themelore, të parashikuara nga nenet 21–58 të Kushtetutës, duhet të trajtohet nga gjykatat e zakonshme sipas kategorizimit të të drejtave kushtetuese, dhe e drejta e pronës duhet të jetë më e rëndësishme për interesat e kërkuesve se sa të drejtat e tjera kushtetuese (*shih paragrafin 41 të vendimit*), hierarki kjo që do të përmbyste konceptin e përparësisë në radhën e shqyrtimit të çështjeve, çka bie ndesh me thelbin dhe qëllimin e këtij kriteri kushtetues, si kriter që në situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor duhet të përbëjë dallimin në përcaktimin e përparësisë së shqyrtimit të çështjeve.

10. Për më tepër, duke pranuar se ka shkelje të kohëzgjatjes së arsyeshme dhe duke vendosur detyrim për Gjykatën e Lartë, që brenda 6 muajve të shqyrtojë themelin e çështjes, shumica nuk ka reflektuar qasjen e duhur as mbi efektivitetin e vendimeve të saj, të cilat rrezikojnë të mbeten të pazbatuara, dhe as në pamundësinë ose mundësinë e kësaj gjykate për të shqyrtuar këtë çështje. Në këtë drejtim, ajo nuk ka qartësuar se mbi çfarë kriteresh e konsideron afatin 6-mujor të arsyeshëm dhe që u përgjigjet kushteve e mundësive të Gjykatës (relatorit) për të vepruar në çështjen e kërkuesit. Nga ana tjetër, vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së, për sa i përket kategorisë, ka parashikuar se kërkojnë, gjithashtu, përparësi në përshpejtim çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (*shih pikën 3.2, kreu II, të vendimit nr. 78/2019 të*

KL Gj-së), një arsye më tepër për të pasur kujdes në vënien e afateve, që mund të krijojnë përplasje me kalendarin e çështjeve, ku ka çështje më prioritare sipas informacionit mbi këtë çështje. Duke iu rikthyer të dhënave statistikore, rezulton se gjyqtari relator, të cilit i ka kaluar për shqyrtim çështja e themelit të kërkesës, ka paraqitur mendimin e tij me shkrim, duke argumentuar se: i. në Kolegjin Civil të kësaj gjykate ndodheshin për shqyrtim **18.000 çështje civile**; ii. po shqyrtoheshin çështje më të hershme në kohë, sipas datës së regjistrimit, **ku më e hershmja i përkiste vitit 2011** dhe se kolegji kishte në shqyrtim në seancë gjyqësore çështje që u përkisnin viteve 2011, 2012, 2013; iii. çështja e kërkesës **ishte regjistruar në vitin 2018** dhe asaj nuk mund t'i jepej përparësi, pasi nuk paraqiste shkaqe të veçanta që prevalonin mbi kriterin e radhës së regjistrimit. Në këtë kontekst faktesh, qasja e shumicës nuk duket realiste, vjen si e shkëputur nga realiteti kompleks i organizimit dhe funksionit të gjyqësorit të zakonshëm aktualisht, edhe pse vetë vendimi objekt ankimi individual e pasqyron më së miri këtë realitet me mbingarkesë çështjesh gjyqësore.

11. Ky qëndrim i pakicës nuk nënkupton në asnjë rast që sistemi gjyqësor nuk duhet të jetë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, megjithatë kjo Gjykatë krahas sigurimit të njëtrajshmërisë të jurisprudencës kushtetuese, për sa i takon vlerësimin e faktorëve që duhet të garantojnë standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet edhe të konstitucionalizojë gjyqësorin e zakonshëm përmes vendimeve të saj. Gjykata, duke mos zbatuar kriteret e sakta dhe të qarta, po i orienton këto lloj procesesh gjyqësore në subjektivizëm, duke sjellë pasojë edhe për gjyqësorin e zakonshëm, në lidhje me kriterin *“Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi”*.

12. Për të gjitha argumentet e mësipërme, në rastin konkret, në ndryshim nga shumica, çmoj se çështja e kërkesës, e cila ka të bëjë me njohjen e së drejtës së pronësisë për sipërfaqet e pretenduara, për nga natyra e saj nuk kërkon të trajtohet më me përparësi se çështje të tjera, pasi interesi i kërkesës nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.

13. Në këto kushte, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, kompleksitetin e saj, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkesës, vlerësoj se nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, për rrjedhojë kërkesa duhej rrëzuar.

14. Përveç sa më lart, theksoj se ky qëndrim është në të njëjtën koherencë sikundër edhe në çështje të tjera, përkatësisht në vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës, për të cilat kam mbajtur të njëjtin qëndrim.

Anëtare: Elsa Toska